



Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Komisionit të Prokurimit Publik dhe l'Autorità Nazionale Anticorruzione

Komisioni i Prokurimit Publik në Republikën e Shqipërisë, përfaqësuar nga Kryetari, Z. Jonaid Myzyri dhe Autoriteti Kombëtar i Antikorrupsionit, përfaqësuar nga Presidenti, Z. Giuseppe Busia në vijim të quajtura “Palë”:

- Në linjë me vlerat dhe parimet që udhëheqin misionin institucional dhe funksionimin e të dyja Palëve;
- Duke pasur një interes reciprok në shkëmbimin e njohurive midis dy institucioneve për të përmirësuar cilësinë e analizës në rastet e prokurimeve publike, rritjen e njohurive të stafit, efikasitetin e sistemit të prokurimeve publike për të garantuar shtetin e së drejtës;
- Udhëhequr nga parimi i barazisë, mirëkuptimi reciprok dhe interesat e përbashkëta, duke pasur si objektiv final nxitjen e bashkëpunimit mbi të njëjtat çështje;

Palët nënshkruajnë Marrëveshjen e mëposhtme të Bashkëpunimit (MoU):

Neni 1

Qëllimi/Objekti

Në kufijtë e juridiksionit të secilit dhe në linjë me ligjet dhe detyrimet përkatëse/respektive që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare, Palët shprehin dakordësinë për të forcuar marrëdhëniet ndërinstitucionale për shkëmbimin e praktikave më të mira në fushën e prokurimeve publike dhe për të vendosur një marrëdhënie bashkëpunimi mbi çështje të interesit të përbashkët midis dy institucioneve.

Neni 2

Fusha e veprimtarisë/ Aktivitete të përbashkëta

Palët do të bashkëpunojnë nëpërmjet:

- Organizimit të seminareve të përbashkëta, tavolinave të rumbullakëta, konferencave, kurseve profesionale, vizitave të punës, të cilat do të jenë të fokusuara në interesat e

përbashkëta lidhur me çështje që i përkasin prokurimeve publike dhe çështje të tjera edukative;

- Organizimin e takimeve të nivelit të lartë për të diskutuar strategji dhe fusha bashkëpunimi dypalëshe;
- Shkëmbimin e informacioneve, praktikave dhe eksperiencave përkatëse respektivisht në legjislacionin e antikorrupsionit dhe transparencës, mbikëqyrjes në fushën e prokurimeve publike dhe masave përkatëse të marra në këto raste;
- Shkëmbimin e eksperiencave mbi rastet praktike në fushën e prokurimeve publike;
- Shkëmbimin e informacioneve rreth kuadrit ligjor, legjislacionit të prokurimit publik, masat e marra në rastet e mosmarrëveshjeve në fushën e kontratave publike, si edhe shkëmbimin e materialeve analizuese, statistikore dhe raporteve.

Neni 3 Legjislacioni i aplikueshëm

Kjo marrëveshje bashkëpunimi do të aktualizohet nga Palët në përputhje me legjislacionin italian dhe legjislacionin shqiptar, si edhe nga e drejta europiane dhe e drejta publike ndërkombëtare e aplikueshme.

Marrëveshja aktuale nuk përfaqëson një marrëveshje ndërkombëtare nga e cila rrjedhin detyrime në kuptim të së drejtës ndërkombëtare.

Neni 4 Koordinimi mes Palëve

Me qëllim lehtësimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacioneve në mbështetje të kësaj marrëveshje, Palët do të caktojnë personat e kontaktit dhe të gjitha komunikimet do të bëhen nga këta përfaqësues, përveç ndryshimeve në marrëveshje.

Personat e kontaktit do të informojnë Palët respektivisht lidhur me zbatimin e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi.

Për Autoritetin Kombëtar të Antikorrupsionit, ndërmjetës është Lorenza Ponzzone, Ufficio Relazioni Internazionali.

Për Komisionin e Prokurimit Publik, ndërmjetës është Ledja Shuperka, Risorse Umane e Relazioni Internazionali.

Komunikimet do të bëhen në formë të shkruar ose elektronike në adresat e mëposhtme:

Autorità Nazionale Anticorruzione

Adresa: c/o Palazzo Sciarra, Via Marco Minghetti, 10 – 00187, Rome. Email:

relazioni.internazionali@anticorruzione.it

Komisioni Prokurimit Publik

Adresa: “Dëshmorët e Kombit” Blv “Dëshmorët e Kombit”, Pallati i Kongreseve, Kati I, Tiranë.

Email: kpp_info@kpp.gov.al

Neni 5

Shpenzimet

Kjo marrëveshje bashkëpunimi nuk i detyron financiarisht Palët. (Ky memorandum mirëkuptimi nuk nënkupton asnjë angazhim financiar për palët). Aktivitetet e zhvilluara në fushën e veprimtarisë së kësaj marrëveshjeje janë objekt i disponibilitetit financiar të secilës palë dhe i nënshtrohen disponueshmërisë së stafit dhe burimeve financiare të palëve.

Në rastet kur përmbushja e kërkesave të këtij memorandumi bashkëpunimi sjell detyrime financiare, Palët angazhohen t'i përmbushin, në zbatim të legjislacionit respektiv, nevojave të planifikuara dhe burimeve që disponojnë. Palët nuk do të kërkojnë rimbursim të shpenzimeve që rrjedhin nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje mirëkuptimi, nëse nuk përcaktohet ndryshe herë pas here.

Neni 6

Konfidencialiteti dhe përdorimi i logove

Secila palë impenjohet të mbajë konfidencialitetin e informacioneve dhe të dokumentacionit të përcjellë në përputhje me këtë marrëveshje bashkëpunimi, bazuar në kërkesat e legjislacionit respektiv dhe në rastin e kërkesave të palës tjetër.

Informacionet e shkëmbyera nga një Palë në tjetrën do të konsiderohen ngushtësisht të rezervuara dhe nuk mund të shpërndahen jashtë dy institucioneve nënshkruese.

Rregulla përjashtuese do të dakordësohen vetëm nga Palët.

Informacionet mbi këtë marrëveshje do të publikohen në faqet zyrtare të Palëve.

Palët do të publikojnë këtë iniciativë të përbashkët. Në veçanti, stemat e Autoritetit Kombëtar të Antikorrupsionit dhe Komisionit të Prokurimit Publik do të përdoren në ambientet e aktiviteteve të përbashkëta të organizuara në fushën e veprimtarisë së këtij memorandumi.

Çdolloj përdorimi tjetër i këtyre logove kërkon miratimin paraprak të Palës së interesuar.

Neni 7 Ndryshimet dhe shtesat

Ndryshimet ose shtesat e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi duhet të bëhen në formë të shkruar me marrëveshje (ose shtesë-marrëveshje që do t'i lidhet kësaj marrëveshjeje dhe do të jetë pjesë integrale e saj) të përbashkët midis Palëve dhe të zyrtarizohen me protokoll.

Ndryshimet hyjnë në fuqi në datën e nënshkrimit midis Palëve dhe bëhen pjesë përbërëse e marrëveshjes aktuale.

Neni 8 Mbi të drejtat dhe detyrimet

Nga ky memorandum mirëkuptimi nuk burojnë të drejta dhe detyrime të Palëve sipas ligjit ndërkombëtar publik, si dhe nuk ndikon në të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat janë pjesë Republika e Shqipërisë dhe Republika Italiane.

Neni 9 Përgjegjësitë

Secila nga Palët do të jetë individualisht përgjegjëse për ankesat që rrjedhin nga veprimet ose mosveprimet, edhe të personelit respektiv, në raport me këtë marrëveshje. **Neni 10**

Ndryshimet në interpretim

Çdo ndryshim në mënyrën e interpretimit të këtij memorandum bashkëpunimi do të zgjidhet miqësisht nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave të ndërsjella drejtuar Palëve.

(Palët, në rast se lindin mosmarrëveshje gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, marrin përsipër zgjidhjen e tyre me mirëkuptim).

Neni 11 Dispozita të fundit

Kjo marrëveshje bashkëpunimi do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit midis Palëve dhe është e vlefshme për një periudhë 3 (tre) vjeçare.

Në rastin kur kjo marrëveshje do të konsiderohet e kënaqshme, mund të rinovohet për një periudhë më të gjatë se tre vjet nëpërmjet një marrëveshje të re.

Palët mund të kërkojnë tërheqjen nga kjo marrëveshje në çdo kohë duke bërë një njoftim me shkrim të paktën tre muaj para drejtuar Palës tjetër.

Firmosur në dy kopje origjinale, secila në gjuhën italiane, shqipe dhe angleze, të gjitha tekstet identike.

Në rast të një interpretimi të ndryshëm, ka epërsi teksti në gjuhën angleze.

Nënshkruar në Romën, më 13.10.2022.

Komisioni i Prokurimit Publik

Z. Jonaid MYZYRI

Autoriteti Kombëtar i Antikorrupsionit

Z. Giuseppe BUSIA